



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:176801

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514034

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.560/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit F. Sh., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1493/21 të datës 11.08.2021 për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datat 25.03.2024 , në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit F. Sh. dhe mbrojtësen e tij Majlinda Kollçaku-Libusha, në të njëjtën ditë shpalli, ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

F. Sh., i lindur me ..... ne fsh. K. i R., tani me banim ne rr” F. A.” pn K- Pejë, i biri i I. dhe nënës Sh. e gjinisë S., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr....., Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Më parë e gjer me datën 26.06.2021 ne fsh. D./Rugovë, Komuna e Pejës, me dashje dhe në kundërshtim me Ligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me nr. 04/L-086 dhe atë

Nenin 3 pika 1.3 e lidhur me Ligjin për Ndërtim nr. 04-L/110-Neni 14, i pandehuri me pronën e cila udhëhiqet në emër e tij ka ndërtuar një Garazh duke vendosur bazën me beton në atë mënyrë që: pas një kontrole rutinore nga ana e hetuesve policor kishin vërejtur se i pandehuri kishte ndërtuar një garazhe duke e venë edhe bazën me beton e pastaj duke len lidhjet për të vazhduar me tutje ndërtimin e shtëpisë/vilës dhe atë pa leje ndërtimore në pronën e cila është pjesë e territorit të parkut kombëtar, këto punime me datën e lartcekur i janë ndërprerë nga ana e zyrtareve policor dhe zyrtareve të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK),

- me çka ka kryer veprën penale “Ndërtim pa leje” nga Neni 359 par. 4 lidhur me par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së);

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

#### GJYKON

Të pandehurit F. Sh. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 4 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. RRENOHET objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, shpenzimet për rrenim i bart i dënuari.
- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

#### ARSYETIM

a. Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate me datë 11.08.2021 ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1493/21 kundër të pandehurit F. Sh. për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datat 25.03.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit F. Sh. së bashku me mbrojtësin e tij av. Majlinda Kollçaku – Libusha e caktuar sipas detyrës zyrtare si dhe dëshmitari Xh. Sh..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata i administroj provat e propozuara nga prokurori i shtetit, që përfshin administrimin e provave materiale, në bazë të të cilave prova gjykata e nxori përfundimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në arsyet si në vijim.

Vepra penale me te cilën ngarkohet i pandehuri;

I pandehuri F. Sh. është shpallur fajtor për shkak se më veprimet e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka kryer veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Vepra penale e lartpërmendur ka këtë përshkrim ligjor:

Në dispozitën e nenit 359 par. 2, të KPRK-së thuhet së: *“Personi i cili është pronar, investitor apo personi përgjegjës i subjektit juridik, i cili është investitor në objektin në ndërtim pa leje ndërtimi, kur me ligj kërkohet një leje e tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim...”*

*Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni thuhet së: Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në pronë publike apo shtetërore, në pronën e tjetrit, në zonat e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura, zonat me interes të veçantë ekonomik, zonat sanitare për përdorimin e ujit ose zonat e mbrojtur për qëllime strategjike, kryesi dënohet me burgim prej...”*

Pra këtë veprë penale mund ta kryej nder të tjera edhe personi i cili është pronar i objektit në ndërtim pa leje, e që në rastin konkret e kemi të pandehurin F. Sh. si dhe fakti se vendi ku është ndërtuar objekti është pjesë e parkut kombëtarë si zonë e mbrojtur. Kjo veprë penale është e karakterit blanket sepse udhëzon në aplikimin e ligjit për ndërtim. Pra veprimi i kryerjes së kësaj veprë është në shkeljet e ligjit për ndërtim e ne rastin konkret neneve 7 dhe 14 të këtij ligji.

Për tu vërtetuar se është kryer kjo vepër penale duhet te jetë vërtetuar elementet kryesore: a janë zhvilluar punime ndërtimore, a ka pasur lejë ndërtimi, dhe si rrethana kualifikuese vendi ku është ndërtuar?

B. Vendimi në lidhje me fajësinë;

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të aktakuzës gjykata e zhvilloj seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë u administruan provat e propozuara nga prokurori i shtetit, përkatësisht u dëgjua në cilësi të dëshmitarëve Xh. Sh., si dhe u administruan provat materiale Raporti i oficerit V. D. i dt.26.06.2021; Raporti i oficerit S. B. #... të dt. 26.06.2021; Deklarata e dëshmitarit e Xh. Sh.e dhënë në Polici me dt. 26.06.2021; Deklarata e te pandehurit F. Sh. e dhënë në Prokurori me dt. 02.08.2021; Procesverbali i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) nr. 000486 i dt. 05.07.2021; Fotografitë e vendit të ngjarjes të dorëzuara nga mbrojtja dhe prokurori i shtetit; Certifikata pronës për pronën P-.....-...-, pronë e cila figuron në bashkëpronësi  $\frac{1}{4}$  më emër të J. Sh., O. Sh., S. Sh. dhe A. Sh.; Fletë poseduese e lëshuar nga UNMIK-Kosova në vitin 2006.

Dëshmitari Xh. Sh. në shqyrtimin gjyqësor të 25.03.2024, e pas njoftimit nga ana e gjykatës se i njëjti konform nenit 124 të KPP-së, është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar, për shkak të afërsisë që ka me të pandehurin, konkretisht është vëlla i tij, i njëjti ka deklaruar se do të shfrytëzoi të drejtën për të liruar nga dhënia e dëshmisë.

I pandehuri F. Sh. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtëses deklaroi se nuk e kam ditur se është parakusht sipas ligjit që duhet një leje e ndërtimit për të ndërtuar një garazhdë, po që se e kisha ditur se është parakusht një leje e ndërtimit për të ndërtuar garazhden do të kisha kërkuar leje pranë organeve kompetente, arsyeja që e kam ndërtuar garazhden ka qenë për me i lënë drutë dhe pajisjet tjera shtëpiake, garazhda është përfunduar por pasi që është ndalë prej inspektorëve ma nuk kemi vazhduar kurgjo, pllaka nuk ka kur far lidhje për të vazhduar më lartë, garazhda është ndërtuar në parcelën time dhe është të njëjtin nivel të tokës.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti deklaroi se posedon palujtshmeri në fshatin D. në Rugovë dhe është e vërtet se në këtë patundshmëri diku me dt. 22 deri me 23.06.2021 kemi

filluar ta ndërtonim një garazhdë ku fillimisht kemi përfunduar pjesën e temelit respektivisht pllakës së betonit dhe jam investitor së bashku më vëllain tim, është e vërtetë se kam bërë një deklaratë në stacionin policorë në Pejë dhe e kam nënshkruar në procesverbal, pas ballafaqimit të pyetjes nga prokurorin e shtetit i njëjti sqaron se unë kam dashur me ndërtua shtëpi, kur nuk kanë lëshuar leje për shtëpi, kam ndërtuar garazhdën, e për garazhdë nuk kem ditur se duhet leja. Në ballafaqimin e gjykatës se ju po deklaroni se keni filluar për garazhdë për në prokurori keni deklaruar se “diku para dy muajve unë kam filluar të ndërtoi një garazhdë ku e kam betonuar me plloçë më qëllim që të vazhdoj me tutje ndërtimin e një ville, shtëpi me materiale të forta, për ndërtimin e kesaj ville-shtepie dhe unë kam pyetur në Komunë për të paisur me leje, mirëpo të njëjtit kanë thënë se nuk japin leje, mirëpo edhe përkundër këtij fakti unë duke parë se të gjithë po ndërtojnë edhe unë fillove të ndërtoj dhe thash cka të behet me të gjithë të behet edhe me mua”, i njëjti deklaroi se për garazhdë kamë thënë.

Gjykata mbrojtjen e të pandehurit F. Sh. ka vlerësuar si e tillë, e po ashtu edhe në lidhshmëri logjike dhe faktike me provat tjera materiale që gjenden ne shkresat e lëndës, si dhe me deklaratimet e tij të mëhershme, mirëpo ka gjetur se kësaj mbrojtjes duhet falur pjesërisht besimin.

Kjo nga shkakun se i njëjti në prokurori ka deklaruar se “diku para dy muajve unë kam filluar të ndërtoi një garazhdë ku e kam betonuar me plloçë më qëllim që të vazhdoj me tutje ndërtimin e një ville, shtëpi me materiale të forta, për ndërtimin e kesaj ville-shtepie dhe unë kam pyetur në Komunë për të paisur me leje, mirëpo të njëjtit kanë thënë se nuk japin leje, mirëpo edhe përkundër këtij fakti unë duke parë se të gjithë po ndërtojnë edhe unë fillove të ndërtoj dhe thash cka të behet me ta behet edhe me mua”, ndërsa në gjykatë e mohon këtë deklaram duke thene se kam pasur për qëllim të ndërtoj vetëm gazrazhë dhe se nuk e kam ditur qe kërkohet leje.

I njëjti po ashtu bie ne kundërshtim me deklaratën e tij të dhënë në prokurori, ku ka deklaruar se ndihet fajtor për veprimet që kam bërë, përderisa në gjykate deklaroi se nuk ka qenë në dijeni së se duhet leje për garazhdë. Këto deklarime bien ndesh njëra me tjetrën, mirëpo edhe po të ishte e vërteta që i njëjti nuk ka qenë ne dijeni se është duke kryer veprën penale, ignioratia legis non excusat<sup>1</sup>. Andaj, gjykata kësaj mbrojtjes mund t’ia fal vetëm pjesërisht besimin, në lidhje me pjesët ku është deklaruar për punimet e zhvilluara, ndërsa për pjesën tjetër gjykata konsideron se e njëjta është dhënë me qëllim të ikjes apo zvogëlimit të përgjegjësisë penale të njëjtit.

---

<sup>1</sup> “Mosnjohja e ligjit nuk e justifikon askënd”.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, duke shprehur bindjen se më provat materiale dhe personale të administruara në shqyrtim gjyqësor është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit mirë të bazuar se i pandehuri F. Sh. ka kryer veprën penale Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësja e të pandehurit F. Sh. av. Majlinda Kollçaku-Libusha në fjalën përfundimtare ka deklaruar se “Gjate këtij shqyrtimi kryesor u vërtetua se aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë, është ngritur mbi prova të cilat nuk vërtetojnë gjendjen faktike dhe nuk bazohen në Ligjin mbi ndërtim, nga se aktakuza është e ngritur mbi bazën e ndërtimit të një garazhde, e që mbi këtë bazë si provë materiale kemi paraqitur edhe fletën poseduese në të cilën shihet se familjaret e të pandehurit kanë një shtëpi të ndërtuar dhe të legalizuar dhe se mbi këtë bazë i mbrojturi im duke ditur se në këtë parcelë janë rritur që nga gjyshi i tij, dhe gjithë gjeneratat tjera deri me sot, i njëjti duke qenë laik, pranë Stacionit Policor dhe Prokurorisë është dëgjuar pa u konsultuar me një avokat apo me një njohës të ligjit dhe mbi këtë bazë i njëjti ka jap deklaratat e tij dhe sot në fjalën time përfundimtare e lus gjykatën që të mirën për bazë deklarimet e tij të dhëna sot para gjykatës nga se në pretendimet e prokurorisë“ se shihen disa blloko “që i pandehuri i kishte përgatitur për ndërtimin e shpisë një aludim i tillë me shumë bindje është vetëm një pretendim i pabazum dhe përshkrim prokurorisë për ta forcuar aktakuzën e tyre, nga se a nuk mundë të konkludohej e kundërta se ato blloka kane mbetur nga ndërtimi i oje eses së garazhes. Sa i përket fotos të prezantuar nga ne si provë Materiale shumë qartë vërehet se garazhda është e futur në parcelën e të pandehurit dhe se po të analizohet është rafsh me token e tij dhe këtu nuk mundësi të shihet as edhe një gredë apo ndonjë pretendim se i mbrojturi im do të fillonte një ndërtim pa l eje, andaj nga provat e paraqitura, nga deklarimi i të mbrojturit tim i propozoj gjykatës që të mbrojturin tim F. Sh., që ta liroj nga përgjegjësia penale, me arsyetimin se i njëjti ka ndërtuar një garazhdë e cila është pjesë dytësore e lidhur me shtëpinë e tyre”.

I pandehuri F. Sh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah deklarimin e mbrojtëses time, nuk kam çka të shtoj tjetër.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata duke u bazuar ne nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar nëse secila prove veç e veç dhe te gjitha së bashku do të vërtetonin faktet relevante – vendimtare për të cilat ngarkohet i pandehuri nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri më parë e gjerë me datën 26.06.2021 në fshatin D. në Rugovë e ka ndërtuar një Garazh duke vendosur bazën me beton dhe gjithashtu është vërtetuar përkatësisht është bërë jokontestuese nga i pandehuri se për këtë ndërtim nuk ka pasur leje ndërtimi .

Gjykata konsideron se është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se i pandehuri ka qene i vetëdijshëm se për ndërtimin e këtij objekti kërkohet leje ndërtimi, kjo vërtetohet me vetë deklaratën e të pandehurit të dhënë në prokurori me datë 10.08.2021 ku deklaron se “kam kërkuar për leje në Komunën e Pejës dhe pasi qe jam njoftuar se nuk lëshohet leje e kam vazhduar ndërtimin” nga kjo shihet se i njëjti parimisht ka qene në dijeni se kërkohet leje, mirëpo me qenë se se nuk është pajisur me leje ka vazhduar ndërtimin edhe pa të njëjtën, andaj gjykata konsideron se ne këtë rast nuk mund të vije në shprehje instituti i lajthimit juridik siç përcaktohet në nenin 26 të KPRK-së.

Nuk është kontestuese se ne këtë rast dhe për këto lloje ndërtimi kërkohet leje, kjo është e rregulluar me legjislacion të veçantë, përkatësisht nenin 14 i Ligjit 04/L-110 Për Ndërtim ka përcaktuar si në vijim:

“1. Leja ndërtimore kërkohet për aktivitetet vijuese:

1.1. ndërtimi i ri (përfshirë montazhet);

1.2. rindërtimi i objekteve ekzistuese;

1.3. rrënimi i objekteve ekzistuese, dhe

1.4. riparimi i objektit ndërtimor, nëse ndodh ndryshim thelbësor i tij krahasuar me situatën para paraqitjes së dëmit nga katastrofat natyrore, luftërat apo ngjarjet e ngjashme. 1.5. intervenimet në fasadat dhe strukturën (sanimet) e një objekti ekzistues.”

E ne këtë rast është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se kemi të bëjmë më ndërtim të ri, pasi qe i pandehuri në prokurori e ka konfirmuar se e ka ndërtuar garazhin, me qellim qe mbi të të ndërtoj villë banimi.

Së fundi, është fakt notor se fshati D. është pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, gjë cila vërtetohet edhe nëse shikohet Plani Hapsinor i parkut, ku ky fshat përshkruhet si pjesë e parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

E fakti se ky fshat hynë në kuadër të fshatrave “zonë e mbrojtur” përcaktohet në nenin 3 par.1 pika 1 të Ligjit Për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuan” ku thuhet “Zona e parë - përfshinë pjesët e territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte”.

Nga gjendja e fakteve të vërtetuara si dhe me provat e administruara personale dhe materiale-formale, gjatë këtij shqyrtimit kryesor, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri F. Sh. me veprimet e tij është inkriminuar në figurën e veprës penale Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

#### C. Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej katër vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej dy vitesh për të pandehurin u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 lidhur me par 2 të KPRK-së është dënim prej katër vite burgim<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Udhëzues për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.



Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin si rrethana renduese duhet të merret fakti se ka ekzistuar dashja që veprën ta kryej në mënyrë të përshtetur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryerja dhe ka dëshiruar kryerjen e tyre, ndërsa si rrethana lehtësuese gjeti se i njëjti me herët nuk kishte ra ndesh me ligjin dhe të është dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit F. Sh. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej katër vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.2 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, e në këtë rast gjykata gjeti se mund të zbatohet dispozita për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 pika 2 dhe 3 të KPRK-së përkitazi me kushtëzimin e dënimit me burgim, përkatësisht duke u bazuar në faktin se është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Kur u vendos për rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje e te përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së ku është paraparë se “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënit barten te kryesi”, pra dispozita materiale ka paraparë që objekti i ndërtuar pa leje duhet që të rrënohet dhe kjo nuk është dispozitë alternative për gjykatën për është normë obligative.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.560/21, me datë 26.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues

Leon Përlaska

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.